



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.625 /2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijeta Sada-Gllogjani dhe Adnan Konushevci, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Lëvizjës Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021 që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I. PRANOHEN** të bazuara ankesat e evidentuara si: Anr.625/2021, Anr.626/2021, Anr.627/2021, Anr.628/2021, të gjitha të datës 17.10.2021, të paraqitura nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndërsa Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 1,200.00 (nje mijë e dyqindë) euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyerja e heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale.

**II. DETYROHET** subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

### A r s y e t i m

Me datë 17.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.625/2021, Anr.626/2021, Anr.627/2021 dhe Anr.628/2021, të gjitha të datës 17.10.2021, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilat pretendohet se kandidatët për kryetar dhe kuvend komunal, kanë bërë fushatë në rrjetin social Facebook, në ditën e heshtjes Zgjedhore dhe në ditën e votimit.

Në ankesën Anr.625/2021 e pranuar më datë 17.10.2021, pretendohet se aktivistët e LVV-së më datë 16.10.2021, rreth orës 14:40, kanë vërejtur se kandidati i LDK-së për Kuvendin komunal të Komunës së Prishtinës Naser Ramadani, ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponsorimin e postimeve me përmbajtje elektorale të cilat janë shfaqur në rrjetin social facebook, duke bërë thirrje për votimin e kësaj partie politike si dhe kandidatin në fjalë, përmes përmendjes së numrit zgjedhor të LDK-së.

Në ankesën Anr.626/2021 e pranuar më datë 17.10.2021, pretendohet se aktivistët e LVV-së më datë 16.10.2021, rreth orës 14:40, kanë vërejtur se kandidati i LDK-së për Kryetar të Komunës së Prishtinës Përparim Rama, ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponsorimin e postimeve me përmbajtje elektorale të cilat janë shfaqur në rrjetin social facebook, duke bërë thirrje për votimin e kësaj partie politike si dhe kandidatin në fjalë, përmes përmendjes së numrit zgjedhor të LDK-së.

Në ankesën Anr.627/2021 e pranuar më datë 17.10.2021, pretendohet se aktivistët e LVV-së më datë 16.10.2021, rreth orës 12:14, kanë vërejtur se kandidati i LDK-së për Kryetar të Komunës së Junikut, Ruzhdi Shehu, ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponsorimin e postimeve me përmbajtje elektorale të cilat janë shfaqur në rrjetin social facebook, duke bërë thirrje për votimin e kësaj partie politike si dhe kandidatin në fjalë, përmes përmendjes së numrit zgjedhor të LDK-së.

Në ankesën Anr.628/2021 e pranuar më datë 17.10.2021, pretendohet se aktivistët e LVV-së më datë 16.10.2021, rreth orës 12:42, kanë vërejtur se kandidati i LDK-së për Kryetar të Komunës së Podujevës Ekrem Hyseni, ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponsorimin e postimeve me përmbajtje elektorale të cilat janë shfaqur në rrjetin social facebook, duke bërë thirrje për votimin e kësaj partie politike si dhe kandidatin në fjalë, përmes përmendjes së numrit zgjedhor të LDK-së.

Në vazhdim pretenduesi në të gjitha ankesat ka theksuar se sponsorimi i postimeve të kandidatëve për kryetar të komunave të cekura në ankesa dhe kandidatit për kuvend komunal të subjektit politik LDK, siç edhe vërehen postimet kanë vazhduar edhe në kohë të heshtjes zgjedhore, dhe kjo mund të dëshmohet në provat e bashkangjitura të ankesave-CD, në të cilën vërehet ora dhe data e saktë e këtyre postimeve, të marrura nga platforma e rrjetit social facebook.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës pretendon se kandidatët e subjektit politik LDK të cekura në këto ankesa kanë thyer heshtjen zgjedhore të sanksionura me nenin 36 par.1 pika b) të LZP-së dhe me nenin 8 par.1 pika c) Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale dhe CD.

Në përgjigjen në ankesë me numr protokoli Anr.625/2021, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe vet kandidati e kundërshtojnë pretendimin e subjektit politik LVV, se ka shkelje të nenit 36 par.1 pika b) të LZP-së, respektivisht shkelje të heshtjes zgjedhore, ngase nga provat e ofruara nuk argumentohet pretendimi i ankuesit, pasi që z.Naser Ramadani si provë ka bashkangjitur fotot të cilat tregojnë se postimi në rrjetin social facebook është lëshuar në fillim të tetorit teksa sponsorizimi është ndaluar më 11 tetor 2021 në ora 11:26.

Përgjigjes në ankese i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara nga rrjeti social-facebook.

Lidhja Demokratike e Kosove (LDK) në përgjigjen në ankese me numër me numër protokolli 627/3, të datës 17.10.2021 e ka kundërshtuar pretendimin e subjektit politik të LVV-se, se ka shkelje të heshtjes zgjedhore, nga se provat e ofruara janë kundërshtuar me dëshmi tjera nga ankuesi dhe ka kërkuar nga PZAP-i shqyrtim të drejtë të këtij rasti dhe mbi bazën e vlerësimit të tij të vendos në mënyre meritore.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive – CD të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.625/2021, Anr.626/2021, Anr.627/2021 dhe Anr.628/2021, të gjitha të datës 17.10.2021 të cilat për nga përmbajtja dhe për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitësi i të gjitha ankesave është subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër kandidatëve të subjektit të njëjtë politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se kandidati për kryetar të komunës së Prishtinës Perparim Rama, kandidati për kryetar të komunës së Podujevës Ekrem Hyseni dhe kandidati për kryetar të komunës së Junikut Ruzhdi Shehu si dhe kandidatit për Kuvend Komunal në Prishtinë Naser Ramadani, që të gjithë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin social Facebook kanë bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet subjekti politik LDK dhe kandidatët e saj, të apostrofuariat në ankesë ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogaritë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive që janë shfaqur në ditën e heshtjes zgjedhore, të cilat promovojnë subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe kandidatët për kryetar komune dhe kandidatët për kuvend komunal nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, se postimi i kandidatit për Kuvend Komunal të Prishtinës Naser Ramadani në rrjetin social facebook janë bërë në fillim tetorit dhe sponsorizimi është ndaluar më 11 tetor 2021 në ora 11:26 dhe jo siç është pretenduar në ankesë, si dhe pretendimet se kandidati për kryetar të komunës së Prishtinës z. Perparim Rama nuk ka bërë shkelje të nenit 36 paragraf 1 pika b të LZP-së. Këto pretendime Paneli, vlerësoi se nuk qëndrojnë të gjitha ngase përveç atyre postimeve sponsorizuese ka pasur edhe postime tjera që kanë qenë aktive dhe janë shfaqur edhe në ditën e heshtjes zgjedhore gjegjesisht me datë 16 dhe 17 Tetor, dhe të njëjtat kanë qenë të sponsorizuara, në datën e cila ka filluar heshtja zgjedhore. Me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohe të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër, andaj

në këtë rast sponzorizimi i postimeve për shfaqje publike edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, në rrjete sociale, është shkelje e heshtjes zgjedhore, prandaj ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje, janë pranuar si të bazuara.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesën Anr.625.2021, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre, ndërsa lidhur me ankesat tjera PZAP-i nuk ka pranuar përgjigje nga subjekti politik LDK brenda afatit të caktuar.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është përgjegjës për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoja Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, shumë e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoja e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 625 /2021 më datë 18.10.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.